

Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; SHFDUÇK, *Feniksët...*3, 57-58; KMDLNJ, *Regjistri i civilëve...*, FDH-13491; N. Krasniqi, *Kohë...*, 273; FHP, *Haški tribunal, Sudenje Slobodanu Miloševiću*, XX, 7; *Albanian detainee, Tortured in Serb Police Hands, Dies in Hospital*, pasqyra e lajmeve, KIC, 22.07.1998, FDH- 29373; *Albanian Detainee Dies from Serb Police Torture*, pasqyra e lajmeve, KIC, 19.08.1998, FDH-29773.

Laureta (Habib) Shala

(1.04.1984, shqiptare nga Fushtica e Poshtme/Donja Fuštica, komuna e Glogocit/Glogovac, nxënëse.)

Laureta me familje jetonin në fshatin Fushticë të Poshtme/Donja Fuštica. Kur në verën e vitit 1998 nisën luftimet në mes të UÇK-së dhe forcave serbe, Laureta me anëtarët e familjes së vet kishte ikur në pyllin e fshatit Fushticë të Poshtme/Donja Fuštica. Në gusht të vitit 1998, u zhvendosën në **Gjilan/Gnjilane**, te një mik familjar, Ramush Neziri. Në datën **20.10.1998**, në orët e hershme të mëngjesit, policia kishte hyrë në shtëpi dhe mori babanë dhe të vëllain e Lauretës, të cilët ishin ushtarë të UÇK-së. I dërguan në stacionin policor. Së shpejti, Laureta e shqetësuar doli nga shtëpia dhe shkoi në drejtim të panjohur. Që nga ky çast asaj i humbet çdo gjurmë. Në listën e KNKK-së, zhdukja e Lauretës është evidentuar me numër BLG-804781-01.

Burimet: deklarata H.S, FDH-31836; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; FDH, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz*, pyetësor, FDH-27378.

Hashim (Qazim) Shala

(13.02.1943, ashkali nga Obiliqi/Obilić, punëtor, katër fëmijë)

Hashimi jetonte në lagjen e romëve në Obiliqi/Obilić. Nga dy martesat, ai kishte katër fëmijë, dy djem dhe dy vajza. Punonte në NP *Elektroekonomia e Kosovës*, por kishte punuar edhe punë të tjera fizike, për të mbajtur familjen e vet. Në datën **4.12.1998**, rreth orës 12:00, erdhi një polic nga Gjilani/Gnjilane, duke kërkuar nga Hashimi që të nisete me të, për të ngarkuar dru. Që nga ky çast Hashimit i humbet çdo gjurmë. Me qenë se nuk u kthye, të nesërmen bashkëshortja e tij e ka paraqitur zhdukjen e të shoqit në polici. Pas disa ditësh, policia kishte ardhur dhe i kishte treguar asaj se Hashimin e ka rrëmbyer UÇK-ja në afërsi të fshatit **Shillovë/Šilovo**, ndërsa polici që e mori atë kishte shpëtuar. Atë polic, familjarët e Hashimit nuk e kishin parë kurrë më. Mbetjet mortore të Hashimit janë gjetur disa vite pas lufte.

Burimet: KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; AFPRRZHKeM, *Regjistri i të rrëmbyerve...*, FDH-17551; Sindikat radnika JP Elektrokomet, *Stradanja...*, 42; OMPF, *Regjistri i konsoliduar...*, FDH-32367; deklarata F.M, FDH-37118.